



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 4256 Prot.

Tiranë, më 16.06 2026

VENDIM QARKULLUES

Nr. 91 dt. 16.06 2026

“PËR MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT “BACHELOR” NË “AKTIVITETE NË NATYRË DHE TURIZËM SPORTIV”, ME DIPLOMË TË DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETIT TË VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT ME ESCOLA SUPERIOR DE DESPORTO DE RIO MAIOR, INSTITUTO POLITECNICO DE SANTAREM, PORTUGALI”

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, vendimin nr.310 datë 11.05.2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7, 20, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, shkresën nr. 824/4 prot., datë 12.06.2026 të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit “Propozim për kodifikimin e programit të dyfishtë të studimit “Bachelor” në “Aktivitete në natyrë dhe turizëm sportiv”, shkresën e Ministrisë së Arsimit nr. 4516 prot., datë 11.06.2026 “Njoftim mbi vlerësimin e aplikimeve”, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e hapjes së programit të përbashkët “Bachelor” në “Aktivitete në natyrë dhe turizëm sportiv”, me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Escola Superior de Desporto de Rio Maior, Instituto Politecnico de Santarem, Portugali.

2. Programi i përbashkët i studimit do të zhvillohet në gjuhën angleze.
3. Kodi i programit të përbashkët të studimit është P63BA0988A (shkresa bashkëlidhur).
4. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit të USI-së, Bordit të Administrimit si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve të Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

